

VENDIM
Nr.877, datë 27.12.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.495, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, TË PERSONAVE DHE SASISË SË
NEVOJSHME TË KARBURANTIT PËR PËRDORIM NGA ANIJET E PESHKIMIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3/1 e vendimit nr.495, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3/1. Efekti financiar, prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, për 6-mujorin e dytë të vitit 2006, për mbulimin e diferencës ndërmjet çmimit të programuar vjetor të “Armo”, sh.a., dhe çmimit 40 lekë/litri, t’i paguhet kësaj shoqërie nga pakësimi, në të njëjtën shumë, i fondeve buxhetore, të vitit 2006, zëri “Kompensim i energjisë elektrike”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha